



**IP Albania** është kompani franshize e kompanisë prestigjioze IP (Italian Petroleum) Gruppo API Itali me një histori 80 vjeçare në fushën e shpërndarjes së karburanteve të cilësisë së standarteve EU. Aspiratat e grupit janë shtrirja kudo në Shqipëri dhe në Ballkan duke u pozicionuar si lider të cilësisë së karburanteve dhe vajrave lubrifikante të certifikuar me standartet EU. IP Albania është garancia e kilometrave të përshkruar, mirëmbajtjes së çdo makine që përdor karburant IP si dhe shërbimi në kohë, 24 h non stop në çdo pikë në Shqipëri ndërkohë për bizneset ofrohet dhe furnizimi me karburant pranë pikave të biznesit të tyre.

Pozicioni për të cilin mund të aplikoni:

## **Manager Stacioni**

Kriteret që duhet të përmbushin kandidatët:

- Arsim i lartë .
- Eksperiencë pune në fusha të ngjashme minimalisht 1 (një) vit.
- Aftësi shumë të mira komunikuese.
- Të ketë pasur persona nën varësi ku të ketë menaxhuar punën e tyre.
- I aftë të punoj nën presion edhe në orare të zgjatura nëse është e nevojshme.
- Të njohë programet bazë kompjuterike.
- Moshë e kërkuar 30 – 40 vjeç.
- Vendbanimi Durrës.

Detyrat dhe përgjegjësitë :

- Organizimi i punës në pikën e karburantit në mënyrë që objekti ( me të gjithë elementët përbërës të tij ) dhe aktiviteti i shoqërisë të jenë të sigurtë dhe të pacenueshëm .
- Hartimi i grafikut të turneve të operatorëve dhe kontrolli i zbatimit të tij .
- Sigurimi dhe dorëzimi i vlerave monetare në bankë .
- Furnizimi i pikës me karburant, vajra lubrifikantë si dhe materiale të tjera të domosdoshme për funksionimin normal të pikës .
- Garantimi i cilësisë dhe sasisë së karburantit në depozita, vajrave dhe mallrave të tjera.
- Identifikimi i klientëve potenciale të zonës, nevojat e tyre për karburant dhe kërkesat e tyre që të furnizohen aty .
- Identifikimi i konkurrencës, cmimeve dhe politikave të tyre me klientët .
- Zbatimi i legjislacionit , urdhrave dhe rregulloreve të miratuara dhe garantimi i zbatimit të tyre nga ana e operatorëve .
- Mbajtja e dokumentacionit të nevojshëm ligjor, teknik dhe fiskal .
- Ndjekja e procedurave për paisjen e pikës me dokumentat e nevojshme nga autoritetet shtetërore, inspektoriatët etj (IQT, MNZ, DPMK etj.)
- Raportimi për shitjet ditore, ecurinë e punës, problemet dhe difektet e konstatuara etj .
- Instruktimi i operatorëve për njohjen e rregullave për mbrojtjen nga zjarri e shpetimin, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë dhe të garantojë zbatimin e tyre nga të gjithë gjatë punës .
- Kontrolli periodik i të gjitha paisjeve përbërëse të pikes në mënyrë që ato të jenë gjithmonë në gjëndje pune në mënyrë që të mos çenohet në asnjë rast objekti dhe aktiviteti i shoqërisë (gjeneratori, fikset e zjarrit, cisternat etj).

Të interesuarit mund të dërgojnë CV me foto, letër referencë dhe letër motivimi në adresën e-maili t: [hr@ipbalcan.com](mailto:hr@ipbalcan.com)

Vetëm kandidatët që do të përzgjidhen do të njoftohen për intervistë pranë zyrave të kompanisë.

*Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe do të trajtohet në konfidencialitet të plotë.*